



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 65

Prishtinë, më 24.5.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selvije Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Milena Miliqeviç.

Munguan: Albulena Haxhiu, Doruntinë Maloku, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Endrit Rrustemi, Emrije Bashota, Marigona Lajqi, Serafina Fetahaj, Diellzë Krasniqi, Egzona Zogiani, Marigona Ismajli dhe Yllka Canolli, studentë të Universitetit të Prishtinës; Ardian Zullufi dhe Dredhëza Ahmetgjakaj; Egzon Pacolli, praktikant; Albulena Mavraj, "Epoka e re"; Amire Qamili, BIRN; Gentiana Kadrija, "Kosova press"; Elvinë Sefiu, "Tribuna chanel"; Dren Ajeti, GLPS; Sanije Berisha, OSBE dhe Genc Jaha, KDI.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 15, 19, 26 prill dhe 3 maj 2016;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2015;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr. 05/L087 për Kundërvajtje;

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr.05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuësve dhe punëdhënësve;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja propozoi që pika e tretë e rendit të ditës, të hiqet. Kurse tek pika, të ndryshme, u propozua të diskutohet edhe: Vizita në Agjencinë Kundër Korrupsionit, si dhe për mënyrën për intervistimin e kandidatëve për pozitën drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe caktimin e datës për të diskutuar lidhur me raportin për financimin e institucioneve, të cilat janë në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 15, 19, 26 prill dhe 3 maj 2016

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 15, 19, 26 prill dhe 3 maj 2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr. 05/L087 për Kundërvajtje

Kryesuesja e ftoi kryesuesin e grupit punues, z. Armend Zemaj, që ta arsyetojë raportin me amendamente.

Armend Zemaj, në fjalën e tij, tha se Projektligji për Kundërvajtje është një nga më të rëndësishmit, që i ka munguar sistemit të drejtësisë. Miratimi i këtij projektligji i eliminon rregulloret e vjetra dhe rregulloret e UNMIK-ut. Grupi punues, në vazhdimësi të plotë në konsultim me ekspertë, por edhe me partnerë të tjerë që e mbështesin punën e Kuvendit, por mbi të gjitha, edhe me ato që do ta zbatojnë këtë ligj. Po ashtu, z. Zemaj njoftoi anëtarët e Komisionit se raporti i projektligjit i ka 32 amendamente, ku propozimet kanë ardhur nga puna jonë, por edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Policia e Kosovës.

Meqë nuk kishe vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit.
- II. Projektligji për Kundërvajtje nr. 05/L087 dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore.

III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverballi.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe kërkoi nga anëtarët, të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara, mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr.05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-77 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve, masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve, si dhe kërkoi nga anëtarët, të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-77 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara, mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Të ndryshme

A. Njoftim

Kryesuesja njoftoi anëtarët se më dt. 27.5.2016, ditë e premte, në ora 11:00, është caktuar që të vizitohet Agjencia Kundër Korrupsionit, që do të jetë një takim pune. Të gjithë anëtarët e Komisionit janë të ftuar për vizitë në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

B. Caktimi i datës për intervistimin e kandidatëve për pozitën drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryesuesja, në fjalën e saj, tha se drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit i përfundon mandati i dytë, më 23 shtator dhe sipas ligjit, nuk mund të zgjidhet më shumë se dy mandate i njëjti person. Në konkursin që është hapur për këtë pozitë, kanë aplikuar 29 kandidatë. Intervistimin e këtyre kandidatëve e bën Komisioni për Legjislacion dhe duhet të vendosim për mënyrën e intervistimit të këtyre kandidatëve. Mendoj se intervistimi i kandidatëve duhet të kryhet për një ditë.

Armend Zemaj, në fjalën e tij, tha se pajtohem që të fillojmë me procesin e përzgjedhjes për pozitën drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit, pasi që i kemi nisur procedurat në afatin e rregullt ligjor. Është hera e parë që kemi shpallur konkurs, para se të përfundojë afati. Mendimi im është që të formojmë një grup të punës, që të paraqesë para Komisionit një draft pune, pasi që është një proces i rëndësishëm dhe aty dakordohemi për mënyrën e intervistimit, por edhe për formën sesi do të zhvillohet procedura e përzgjedhjes. Në kuadër të kësaj, do të jenë prezent edhe partnerët që e mbështesin apo organizatat që merren me luftimin e korrupsionit, por edhe organizata tjera, si p.sh. OSBE, NDI etj. Po ashtu, propozoj që nëse kandidatëve nuk iu vjen bezdi, jam ithtar që të pranishëm në intervistim të jenë edhe mediat.

Nezir Çoçaj, në fjalën e tij, tha se pajtohem që shoqëria civile të jetë e pranishme, në mënyrë që intervistimi i kandidatëve të jetë sa më transparent.

Meqë nuk kishte diskutime, Komisioni, në mënyrë unanime, në mbledhjen e mbajtur më 24.5.2016, nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit të punës për shqyrtimin e aplikacioneve për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

1. Formohet grupi i punës, në këtë përbërje:

Agim Ademaj, kryesues
Agim Aliu, anëtar; dhe,
Milena Miliqeviç, anëtare.

C. Caktimi i datës për të diskutuar lidhur me raportin për financimin e institucioneve të cilat janë në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion

Kryesuesja propozoi që në mbledhjen e radhës, të diskutohet për shpenzimet dhe kërkesat buxhetore me institucionet që bien në fushëveprim të Komisionit. Komisioni u pajtua që në takimin e radhës të ftohen përfaqësuesit e këtyre institucioneve: Ministrisë së Drejtësisë; Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Institutit Gjyqësor të Kosovës; Prokurorit të Shtetit; Agjencisë Kundër Korrupsionit; Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se anëtarët e Komisionit, në mënyrë unanime, u dakorduan që në mbledhjen e radhës, të ftojnë përfaqësuesit e këtyre institucioneve.

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të jetë më 31.5.2016, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi

Aneks- Amendamentet e miratuara për Projektligjin nr. 05/L087 për Kundërvajtje.

Amendamenti 1

Neni 2, paragrafi 1, riformulohet si vijon: “ 1. Kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojtja e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës”.

Amendamenti 2

Neni 4i projektligjit, fjalët: “nëse nuk është fajtor për kundërvajtjen e kryer”, zëvendësohen me fjalët “ *deri sa nuk është shpall fajtor me vendim të formës së prerë.*”

Amendamenti 3

Në nenin 10, në neni 26 në titull dhe në paragrafin 1, nenin 45 në titull, në nenin 46, paragrafi 3, dhenë nenin 48, paragrafi 15, fjala “përshtatshmëri”, zëvendësohet me fjalën “*përshtatshmëri*”.

Amendamenti 4

Neni 30, paragrafi 1, në rreshtin e tetë, pas fjalës “të pandehurit”, shtohen fjalët “organi i kundërvajtjes apo” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 30, paragrafi 4, pas fjalës “përmbartim”, shtohen fjalët “Urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoha do të cilësohet dokument përmbartës në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën përmbartimore”.

Amendamenti 5

Neni 33, paragrafi 4 i projektligjit, fjalët: “vepra penale”, zëvendësohet me “*kundërvajtja*” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 6

Neni 38, paragrafi 5 i projektligjit, riformulohet si vijon: “*Prej kryerësit do të merren të hollat, sendet me vlerë dhe çdo përfitim tjetër pasuror, që ka përfituar nga kundërvajtja. Nëse marrja është e pamundur, do të obligohet kryerësi që ta paguajë shumën në të holla që i përgjigjet përfitimit pasuror.*”

Në nenin 38, paragrafi 6, fjalët: “*i vënë në dorë*”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 7

Neni 40, paragrafi 1 i projektligjit, fjalët: “i padëshirueshëm” zëvendësohen me fjalët “*në kundërshtim me Ligjin për të huajt*”.

Amendamenti 8

Neni 41, paragrafi 7 i projektligjit, riformulohet si vijon: “ 7. Evidencën e kundërvajtjes të shqiptuar nga gjykatat e mban Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Mënyra e mbajtjes përcaktohet me akt nënligjor nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës”.

Amendamenti 9

Neni 48, paragrafi 1 i projektligjit fjalët: “përveç nëse vendimi merret në procedurën urgjente”, **hiqen**.

Amendamenti 10

Në nenin 50 të projektligjit, në rreshtin e dytë, fjalët: “*ashtu që*”, **hiqen** dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 11

Neni 56, paragrafi 2.1 i projektligjit, fjalët: “shumë e përcaktuar saktë”, zëvendësohen me “**shumën e caktuar**”.

Amendamenti 12

Neni 58, hiqet dhe renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 13

Neni 61, paragrafi 1 i projektligjit, riformulohet si vijon:

”1. Në rast se pala parashtron kundërshtimin ndaj sanksionit kundërvajtës, procedura zhvillohet pranë organit të kundërvajtjes nga komisioni për vendosje, në përbërje prej së paku 3 (tre) anëtarëve. Parashtrimi i kundërshtimit duhet të bëhet brenda 8 (tetë) ditëve dhe i njëjti shtyn ekzekutimin për pagimin e gjobës në pajtim me dispozitat e këtij ligji”.

Amendamenti 14

Neni 63, paragrafi 1 i projektligjit, në rreshtin e katërt, pas fjalës “ligjit”, shtohet lidhëza “në” dhe teksti vazhdon si në projektligj, kurse në rreshtin e pestë, fjala “prokurojë”, zëvendësohet me “administroj” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 15

Pas nenit 63 të Projektligjit, shtohet neni i ri, me përmbajtje si vijon:

“Neni 63

Zbatimi përshtatshmërisht i dispozitave të Ligjit për procedurën administrative

Organi i kundërvajtjes me rastin e zhvillimit të procedurës së kundërvajtjes, përshtatshmërisht i zbaton dispozitat e Ligjit për procedurën administrative, përveç nëse me këtë ligj dhe me ligjin me të cilin është paraparë kundërvajtja nuk është përcaktuar ndryshe”.

Amendamenti 16

Neni 64, paragrafi 1 i projektligjit, në rreshtin e parë, pas fjalës “vendimit”, shtohet fjala “përfundimtarë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 64, paragrafi 2 i projektligjit, në rreshtin e shtatë, fjalët “tregtarin individ”, zëvendësohen me “*biznes individual*” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 17

Neni 65, paragrafi 1 i projektligjit, fjala “8 (tetë)”, zëvendësohen me “30 (tridhjetë)” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 18

Në kapitullin XIII, në titull të projektligjit, pas fjalës “PROCEDURË”, shtohen fjalët: “ NË GJYKATË”.

Amendamenti 19

Neni 74, paragrafi 1 i projektligjit, në rreshtin e tetë dhe të dhjetë, fjala “lutjen”, zëvendësohet me “*kërkesën*” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 20

Neni 78, paragrafi 4 riformulohet si vijon:

“4. Kur votat për ndonjë çështje individuale për të cilën duhet votuar ndahen në disa mendime të ndryshme, kështu që asnjëri prej tyre nuk e ka shumicën, çështjet ndahen dhe votimi përsëritet, derisa të arrihet shumica e votave. Nëse edhe në këtë mënyrë nuk arrihet shumica e votave, vendimi do të merret në atë mënyrë që votat që janë më të disfavorshme për të pandehurin, do të numërohen me votat të cilat janë më pak të favorshme se këto, gjithnjë, derisa të arrihet shumica e nevojshme e votave.

Amendamenti 21

Neni 99, paragrafi 2 i projektligjit, riformulohet si vijon:

”2. Gjatë marrjes në pyetje i pandehuri duhet të tregojë emrin dhe mbiemrin, nofkën nëse ka; emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij; vendlindjen dhe vendbanimin e tij; ditën, muajin dhe vitin e lindjes; numrin e tij personal të identifikimit; kombësinë dhe shtetësinë; profesionin dhe

rrethanat familjare; shkollimin; a ka të ardhura personale edhe pozitën e tij materiale; dhe nëse është i mitur, identitetin e përfaqësuesit të tij ligjor”.

Neni 99, paragrafi 6 i projektligjit, në rreshtin e gjashtë, fjala “sipërmarrësve”, zëvendësohet me “ndërmarrësve”.

Amendamenti 22

Neni 102, paragrafi 3 i projektligjit, në rreshtin e pestë, fjalët: “ të lodhjes”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 102, nënparagrafi 5.4 i projektligjit, në rreshtin e dytë, fjalët: “nën kërcim”, zëvendësohet me “ nën kërcënim” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 23

Neni 104, nënparagrafi 1.2 i projektligjit, riformulohet si vijon:”1.2. personat me gjini të gjakut të të pandehurit në vijën e drejtë pa kufi, personat në gjini të gjakut në vijën anësore deri në shkallën e katërt, si dhe personat e gjinisë së krushqisë deri në shkallën e dytë;”

Amendamenti 24

Kapitulli XXII, titulli dhe neni 114, riformulohen si vijon:

“URDHËRKONTROLLI I LOKALEVE DHEI PERSONAVE

”Neni 114

Procedura para fillimit të kontrollit

Urdhërkontrolli caktohet me urdhëresë me shkrim të gjyqtarit, i cili e zhvillon procedurën e kundërvajtjes. Zbatimin e kontrollit e bën Policia e Kosovës, përveç nëse me urdhëresë për kontroll përcaktohet ndryshe”.

Amendamenti 25

Neni 115 i projektligjit, riformulohet si vijon:

“Neni 115

Mënyra dhe veprimet gjatë zbatimit të urdhërkontrollit

Të gjitha veprimet nga zyrtari që zbaton urdhërkontrollin e që përshin: kufizimet në ekzekutimin e urdhërkontrollit, procedurën para fillimit të kontrollit dhe kufizimet në kontroll, bëhen në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës”.

Amendamenti 26

Neni 116, paragrafi 6 i projektligjit, në rreshtin e parë, fjalët: “paratë e fituara”, zëvendësohen me fjalët:”të hollat e fituara” dhe teksti vazhdon si në projektligj. Ky ndryshim vlen për tërë tekstin e projektligjit, ku fjala “paratë”, zëvendësohen me fjalët” të hollat”.

Në nenin 116, paragrafi 7, në rreshtin e pestë, fjala “qiten” zëvendësohet me “ deponohen” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 27

Në nenin 117, paragrafi 4, në rreshtin e pestë, fjalët: ”institucionit monetar”, zëvendësohet me “bankës”.

Amendamenti 28

Neni 126, në titull, fjala “pezullimin”, zëvendësohet me “përfundimin” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 126, paragrafi 1 i projektligjit, fjala “pezullohet”, zëvendësohet me “ përfundoj” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 126, nënparagrafi 1.4 i projektligjit, në rreshtin e katërt, fjala” “pezulluar”, zëvendësohet me “përfunduar” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 126, paragrafi 2 i projektligjit, fjala “pezullohet”, zëvendësohet me “përfundohet” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 29

Në nenin 143, në paragrafët 1,2,5,6; nenin 144, paragrafët 2 dhe 3 dhe në nenin 158, paragrafi 2 i projektligjit, fjalët: ”abrogojë/abrogohet/abrogon/abrogimit”, zëvendësohet me fjalët “shfuqizojë/ shfuqizohet/shfuqizimit” , sipas kontekstit të fjalisë.

Amendamenti 30

Neni 164, paragrafi 4 i projektligjit, riformulohet si vijon:

“4. Të hollat e fituara nga shitja e sendit që është në pronësinë e të ndëshkuarit, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Nëse sendi nuk është në pronën e të ndëshkuarit, të hollat nga sendi i shitur i dorëzohen pronarit”.

Amendamenti 31

Neni 166 i projektligjit, fjalët: “Arkëtimin me dhunë e bën gjykata e cila ka vendosur në shkallë të parë sipas dispozitave që vlejnë për procedurën e përmbarimit”, zëvendësohen me “*Arkëtimi me dhunë bëhet sipas dispozitave që vlejnë për procedurën e përmbarimit*”.

Amendamenti 32

Neni 171 i projektligjit, fjalët: “më 1 janarit të vitit, “zëvendësohen me “në janar të vitit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.